



OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2024

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)

Drejtuar: OE “DROMEAS Albania” sh.p.k. **me NIPT K91628005M**
Tiranë, Bulevardi Gjergj Fishta, Kompleksi Tirana 2000, Kulla Matrix,
Kati përdhe.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me mjete elektronike –
Mallra.

Numri i referencës së procedurës: REF-06971-05-28-2024.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje karrige për nevojat e OST sh.a.”.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.29, datë
03.06.2024.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në
çmim.

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e
mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

- 1. OE “SHAGA.” sh.p.k.** **me NIPT J96822229J**
Vlera 7,212,700 (shtatë milion e dyqind e dymbëdhjetë mijë e shtatëqind) Lekë pa
TVSH.
- 2. OE “DROMEAS Albania” sh.p.k.** **me NIPT K91628005M**
Vlera 8,652,000 (tetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë) Lekë pa TVSH.
- 3. OE “Mudo Concept Albania” sh.p.k.** **me NIPT K91902012M**
Vlera 8,847,500 (tetë milion e tetëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH.
- 4. OE “VOKA” sh.p.k.** **me NIPT L81507504S**
Vlera 8,848,080 (tetë milion e tetëqind e dyzet e tetë mijë e tetëdhjetë) Lekë pa TVSH.
- 5. OE “KLAME” sh.p.k.** **me NIPT K21518003F**

Pa ofertë ekonomike.

6. OE “MUCA” sh.p.k.

me NIPT K01421002H

Pa ofertë ekonomike.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE “SHAGA.” sh.p.k., me NIPT J96822229J, për arsye se:

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.2, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi apo distributori të autorizuar, konkretisht për mostrat e paraqitura për Artikujt me nr.3.4.5, autorizimet e paraqitura nga ofertuesi ekonomik nuk korrispondojnë me prodhuesin apo distributor të autorizuar për mostrat e paraqitura.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.3, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi në tabelën e plotësuar jepen të dhëna që nuk korrispondojnë me mostrat e paraqitura.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.5, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi katalogët/skedat teknike të paraqitura nuk korrispondojnë me mostrat e ofruara.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.7, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi mostrat e paraqitura nuk janë në përputhje me specifikimet teknike për pjesën më të madhe të sasisë së mallrave të kërkuara, konkretisht:

Modeli 1 (102 karrige)	
Është kërkuar:	Është paraqitur:
Aktivizimi i mekanizmit të mbështetjes duhet të arrihet nëpërmjet të njëjtës levë që përdoret për rregullimin e lartësisë së sediljes.	Aktivizimi i mekanizmit të mbështetjes arrihet me nje leve tjetër, jo të njëjte.
Mbështetja e shpinës të përbëhet profile çeliku.	Mbështetja e shpinës përbëhet profile plastike.
Ngjyra e karriges (e cila do të jetë e kuqe ose e zezë)	Ngjyra e karriges blu.

Modeli 2 (70 karrige)	
Është kërkuar:	Është paraqitur:
Aktivizimi dhe çaktivizimi i lëvizjes Synchro të arrihet përmes të njëjtës levë që përdoret për rregullimin e lartësisë së sediljes.	Aktivizimi dhe çaktivizimi i lëvizjes arrihet përmes nje leve të dyte, jo të njëjte.
Mbështetja e shpinës të përbëhet profile çeliku.	Mbështetja e shpinës përbëhet profile plastike.

2. OE “Mudo Concept Albania” sh.p.k., me NIPT K91902012M, për arsye se:

Nuk ka përmbushur pikën 1/a, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas kërkesës së nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Nuk ka përmbushur pikën 2.2.1, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur kopje të certifikuara të bilanceve, për të provuar se nuk ka raport negativ

ndërmjet aktivitet dhe pasivitet, sipas kërkesës së nenit 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.1, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar se ka realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata të ngjashme.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.2, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi apo distributori të autorizuar për mallrat objekt prokurimi, për të cilat ka paraqitur mostra.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.3, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur tabelën e kërkuar në DST për të specifikuar vendin e origjinës dhe certifikimet përkatëse për mallrat objekt prokurimi.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.4, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur certifikatën ISO 9001.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.5, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur katalogët/skedat teknike për të gjithë mallrat objekt prokurimi.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.7, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi mostrat e paraqitura nuk janë në përputhje me specifikimet teknike, konkretisht:

Modeli 2 (70 karrige)	
Është kërkuar:	Është paraqitur:
Mbështetësja vishet me rrjetë	Mbështetësja vishet me lekure.

Modeli 4 (51 karrige)	
Është kërkuar:	Është paraqitur:
Krahët e karrigeve të jenë të përbërë nga poliamidi termoplastik dhe i rregullueshëm në lartësi.	Krahët e karrigeve janë fikse, statike.
Koka e karriges të ketë mekanizëm të lëvizshëm dhe të lëvizë lart-poshtë. Mbulesa e jastëkut të jetë me lekure artificiale/prodhuar.	Koka e karriges mungon.

Modeli 5 (4 karrige)	
Është kërkuar:	Është paraqitur:
Mbështetëse krahësh të rregullueshme në lartësi dhe gjerësi.	Krahët e karrigeve janë fikse, statike.
Rregullimi i lartësisë së shpinës dhe thellësisë së sediljes.	Shpina është e palevizshme.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.9, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka vërtetuar se disponon të paktën 3 punonjës.

3. OE “VOKA” sh.p.k., me NIPT L81507504S, për arsye se:

Oferta refuzohet, në zbatim të pikës 3, të nenit 82, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi shuma absolute e të gjithë

korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar në Shtojcën 1 dhe 2.

Në shtojcën 1 “formulari i ofertës”, ofertuesi ka deklaruar me shifra dhe me fjalë çmimin total të ofertës me vlerë: 8.848.080 (tetëmilion e tetëqind e dyzet e tetë mijë e tetëdhjetë) Lekë pa TVSH ose 10.617.696 (dhjetë milion e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) Leke me TVSH. Kjo shtojcë mban datën e nënshkrimit 26.04.2024.

Tek shjojca 2 “Lista e çmimeve”, çmimi total i 5 artikujve mban vlerën 7.352.300 (shtatë milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind) Lekë pa TVSH. Tek e njëjta shtojcë, tëk e njëjta tabelë zërash ka një gabim përlllogaritje për zërin nr.5, ku çmimi për njësi nuk korrespondon me çmimin total për artikulin nr.5, duke sjellë një gabim përlllogaritje matematike në shumën absolute e të gjithë artikujve mbi 2% te vlerës ekonomike të ofruar në shtojcën 1 dhe në shtojcën 2. Theksojmë dhe se data e nënshkrimit tek shtojca 2 është 11.03.2024.

4. OE “KLAME” sh.p.k., me NIPT K21518003F, për arsye se:

Nuk ka përmbushur pikën 1/b, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës, sipas kërkesës së nenit 83, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.2, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi apo distributori të autorizuar për mallrat objekt prokurimi.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.3, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur tabelën e kërkuar në DST për të specifikuar vendin e origjinës dhe certifikimet përkatëse për mallrat objekt prokurimi.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.4, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur certifikatën ISO 9001.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.5, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur katalogët/skedat teknike për të gjithë mallrat objekt prokurimi.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.6, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur deklaratë se mallrat objekt procedure prokurimi që do të furnizojë janë të reja dhe të pa perdorura me pare.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.7, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur mostrat e kërkuara për mallrat objekt prokurimi.

Nuk ka përmbushur pikën 2.3.8, të Kritereve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk ka paraqitur deklaratë se jep miratimin për kryerjen e analizave dhe të dhënat e kontaktit, për dërgimin e mostrave dhe dërgimin e tyre pranë laboratorit për treguesit fiziko-mekanik e tekstil.

5. OE “MUCA” sh.p.k., me NIPT K01421002H, për arsye se:

Nuk ka paraqitur asnjë dokument të kërkuar në DST, përfshirë ofertën ekonomike.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “DROMEAS Albania” sh.p.k., me NIPT K91628005M**, Adresa: Tiranë, Bulevardi Gjergj Fishta, Kompleksi Tirana 2000, Kulla Matrix, Kati përdhe, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **8,652,000 (tetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë) Lekë pa TVSH**, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

ADMINISTRATOR I OST SH.A.

Skerdi Drenova